



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 813/ Prot.

Tiranë, më 01 . 08 . 2025

VENDIM

Nr. 200, datë 25.07.2025

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT ERVISA HYKA NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 25.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për transferimin e prokurorit Ervisa Hyka në Prokurorinë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së
lëvizjes paralele”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2113 prot., datë 23.07.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, *“Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli 18 (tetëmbëdhjetë) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë, Tiranë, Korçë, Kukës dhe Vlorë, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Njëri ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant nr. 5, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj, janë njoftuar në faqen zyrtare të Këshillit më datë 20.02.2024. Pas përfundimit të afatit të aplikimit më datë 06.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi punën me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve.
4. Me Vendimin nr. 37, datë 28.03.2024, *“Për fillimin e verifikimit të kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kualifikohen për të vijuar garën. Në po të njëjtin vendim, Këshilli vendosi nëpërmjet procedurës së shortit caktimin e relatorit për secilin nga pozicionet e shpallura. Për pozicionin vakant nr. 5, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë u zgjodh relator z. Sokol Stojani.
5. Në zbatim të nenit 11, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 261, datë 17.11.2020, *“Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, i ndryshuar, (në vijim Rregullorja)*, kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion janë njoftuar për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar të Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
6. Meqenëse pas kalimit të këtij afati nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit, është filluar puna për verifikimin e plotësimit të kriterëve të vlerësimit nga ana e kandidatëve, bazuar në nenin 43, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar (në vijim, *Ligji për Statusin*) si dhe në nenet 8, 15 dhe 21, të Rregullores.

7. Me Vendimin nr. 156, datë 11.06.2025, *“Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant nr.5 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit”*, Këshilli miratoi renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin vakant nr. 5, në zyrën e Prokurorisë Tiranë, si vijon:

1. Ervisa Hyka;
2. Aida Cakaj.

8. Vendimi i është njoftuar kandidatëve në datë 15.07.2025, dhe nga zyra e Protokollit pranë Këshillit nuk është administruar në institucion deri më 22.07.2025, asnjë ankim gjyqësor, në kuptim të nenit 22, pika 3, të Rregullores.

9. Në këto kushte, Komisioni i propozoi Këshillit transferimin e zonjës Ervisa Hyka në pozicionin vakant nr. 5, në zyrën e Prokurorisë Tiranë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, bazuar në nenin 45, pika 1, të Rregullores e cila parashikon se:

“Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.”

10. Znj. Ervisa Hyka, me Dekretin nr. 7162, datë 16.11.2011, të Presidentit të Republikës është emëruar prokurore në stazh në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin nr. 7787, datë 12.10.2012, të Presidentit të Republikës është emëruar prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

11. Nga dosja personale rezulton se deri në datë 14.02.2025, znj. Hyka ka rreth 12 (dymbëdhjetë) vjet (147 (njëqind e dyzet e shtatë) muaj) vjetërsi pune si magjistrat, të gjitha përvojë profesionale specifike në atë shkallë për të cilën kandidon.

12. Bazuar në sa më sipër, vlerësohet e përfunduar procedura administrative e shpallur për plotësimin e pozicionit vakant nr. 5, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele të prokurorit Ervisa Hyka në këtë zyrë prokurorie.

13. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave për sa kohë që znj. Ervisa Hyka është e komanduar me Vendimin nr. 388, datë 14.12.2023, *“Për komandimin e prokurores Ervisa Hyka si ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme”*, të Këshillit në pozicionin e Ndihmësmagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme, ato mund të parashikohen jo me efekt të menjëhershëm.

14. Në këto kushte, zbatohet Kodi i Procedurave Administrative, konkretisht pika 3, e nenit 104, *“Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ”*, ku përcaktohet se:

“1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

15. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ do të krijohen konkretisht në datë 28.07.2025, pas miratimit të aktit administrativ (vendimit të caktimit në detyrë me transferim nëpërmjet lëvizjes paralele).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 18, pika 2, 90, pika 2 dhe 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 261, datë 17.11.2020, “Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit Ervisa Hyka në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duke filluar nga data 28.07.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Ervisa Hyka.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 25.07.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdan



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda